



Technical Secretariat of the
National Water Council

MENAXHIMI I INTEGRUAR I BURIMEVE UJORE

LEGJISLACIONI I BE-SË

VLORË, QERSHOR 2018

PËRMBAJTJA

- KUADRI LIGJOR I BE-SË (*ACQUIS COMMUNAUTAIRE*)
- DIREKTIVA KUADËR E UJIT 2000/60/EC
- DIREKTIVAT E BE-SË

ACQUIS COMMUNAUTAIRE

ACQUIS COMMUNAUTAIRE

- ❑ Grupimi i legjislacionit, akteve ligjre dhe vendimeve të cilat përbëjnë shtyllën ligjore të Bashkimit Evropian (**Direktiva, Vendime, Rregullore**).
- ❑ *Acquis* (deri në 2007) ishte e organizuar në 31 kapituj (kapitulli 22 – Mjediti)
- ❑ Nga viti 2013 (kur pati zgjerim të anëtarësimit), *Acquis* përbëhet nga 35 kapituj (kapitulli 27 – Mjediti)
- ❑ Instrumenti ligjor i përafrimit të këtij kuadri ligjor janë “**Marrëveshjet**”
- ❑ Shqipëri – BE Marrëveshja e Stabilizim Asociimit **MSA** për përafrimin e legjislacionit të BE-së 2007 – 2013 (Në nenet 70/3 dhe 108 të saj parashikohet domosdoshmëria e përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis* e Bashkimit Evropian, si dhe zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit të luftës kundër degradimit mjedisor, me qëllim nxitjen e qëndrueshmërisë mjedisore).
- ❑ Në 2014 marrja e Statusit të vendit kandidat për anëtarësim në BE – 5 Rekomandime shtesë

ACQUIS COMMUNAUTAIRE – MJEDISI

- Mbrojtja e Mjedisit (legjislacioni horizontal)
- Menaxhimi i mbetjeve
- Menaxhimi i ujërave**
- Mbrojtja e natyrës
- Cilësia e ajrit dhe zhurmat
- Ndryshimet klimatike
- Organizmat e modifikuar gjenetikisht – Kimikatet
- Pyjet dhe kullotat

DIREKTIVAT E BE-SË – MENAXHIMI I UJËRAVE

- ❑ **Direktiva 2000/60/EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2000 për “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave”, amenduar nga Vendimi 2455/2001/EC dhe Direktivat 2008/32/EC, 2008/105/EC, 2009/31/EC, 2013/39/EU 2013/64/EC dhe 2014/101/EU.
- ❑ **Direktiva e Këshillit 98/83/EC** e datës 3 nëntor 1998 për “Cilësinë e ujit të pijshëm”, amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 596/2009 si dhe nga Direktiva 2015/1787/EC.
- ❑ **Direktiva 91/676/EEC** e datës 12 dhjetor 1991 për “Mbrojtjen e ujërave nga ndotja e shkaktuar nga nitratat e përdorura në bujqësi” amenduar nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008.
- ❑ **Direktiva 2007/60/EC** e datës 23 tetor 2007 për “Vlerësimin dhe manaxhimin e rrezikut nga përmbytjet”.
- ❑ **Direktiva 2008/56/EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 17 qershor 2008 për “Krijimin e një kuadri në fushën e politikave mjedisore detare” (direktiva për kuadrin e strategjisë detare).

DIREKTIVAT E BE-SË – MENAXHIMI I UJËRAVE

- ❑ **Direktiva e Këshillit 91/271/EEC** e datës 21 maj 1991 për “Trajtimin e ujërave të ndotura urbane”, amenduar nga Direktivat 98/15/EC dhe 2016/64/EC, si dhe nga Rregulloret (EC) 1882/2003 dhe (EC) 1137/2008.
- ❑ **Direktiva 2006/118/EC** e datës 12 dhjetor 2006 për “Mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja dhe degradimi” amenduar nga Direktiva 2014/80/EC.
- ❑ **Direktiva 2009/90/EC** e datës 31 korrik 2009 për “Përcaktimin e specifikimeve teknike për analizat kimike dhe monitorimin e statusit të tyre”.
- ❑ **Direktiva 2006/7/EC** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 15 shkurt 2006 për “Manaxhimin e cilësisë së ujërave të larjes” që shfuqizon Direktivën 76/160/EEC të amenduar me Rregulloren (EC) 596/2009 dhe Direktiven 2013/64/EC.
- ❑ **Direktiva 2013/39/EU** e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 12 gusht 2013, e cila amendon Direktivën 2000/60/EC dhe 2008/105/EC për sa i përket substancave prioritare në fushën e politikave të ujit.

DIREKTIVA KUADËR E UJIT 2000/60/EC

DIREKTIVA KUADËR E UJIT 2000/60/EC

Detyrat e shtëpisë

- Monitorimi i burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore (statusi i tyre)
- Hartimi i strategjisë për kontrollin e ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore
- Krijimi i regjistrit të zonave të mbrojtura (ujore)
- Analizë ekonomike për secilin basen ujor
- Hartimi i planeve të menaxhimit të baseneve ujore
- Informimi i publikut dhe Konsultimi në të gjitha proceset dhe fazat

Ligj nr. 111/2012 për “Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar me ligj nr. 6 / 2018

DIREKTIVA KUADËR E UJIT 2000/60/EC

- Përshkrim i karakteristikave të basenit ujor (*ujërat sipërfaqësore, nëntokësore, identifikimi i kushteve referencë*)
- Përmbledhje e presioneve (+ aktiviteti njerëzor) mbi statusin e trupave ujore në basen
- Përpilimi i hartave të zonave të mbrojtura
- Rrjeti i monitorimit dhe rezultatet e monitorimit bazuar në programin respektiv për statusin e trupave ujore (*sipërfaqësore, nëntokësore, zonat e mbrojtura*)
- Objektivat mjedisore
- Analiza ekonomike
- Programi i masave që do merren (+ Lista e masave shtesë)
- Përmbledhje e informacionit mbi konsultimin dhe informimin e publikut

DIREKTIVA KUADËR E UJIT 2000/60/EC KU JEMI NE?

- Strategjia Kombëtare e menaxhimit të integruar të burimeve ujore
- Draft Programi Kombëtar Sektorial për menaxhimin e integruar të ujit
- Ndërtimi i Kadastrës kombëtare elektronike të burimeve ujore
- Ndërtimi i Regjistrit kombëtar të përdoruesve të burimeve ujore
- Krijimi i AMBU, funksionimi i 6 KBU + 6 ZABU**
- Krijimi i GMIP për ujin dhe i 4 nëngrupeve tematike (“ujë për njerëz”, “ujë për ushqim”, “ujë për mjedis”, “ujë për industri”).

DIREKTIVA KUADËR E UJIT 2000/60/EC KU JEMI NE?

- Plani i menaxhimit të basenit ujq Mat (*plan pilot*)
- Plani i menaxhimit të basenit ujq Drin – Bunë
- Plani i menaxhimit të basenit ujq Seman
- Plani i menaxhimit të basenit ujq Shkumbin (+ përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike)
- Plani i monitorimit të basenit ujq Ishëm – Erzen

DIREKTIVAT E BE-SË

DIREKTIVA 91/271/EEC PËR UJËRAT E NDOTURA URBANE

- Identifikimi i zonave sensitive dhe atyre më pak sensitive
- Ndërtimi / projektimi / funksionimi i impjanteve të trajtimit për të arritur disa kërkesa performance specifike
- Përgatitja e rregullave specifike për shkarkimin e ujërave të ndotura urbane dhe industriale
- Identifikimi i Aglomerimeve dhe trajtimi i ujërave të ndotura urbane sipas aglomerimeve
- Menaxhimi i llumrave që prodhohen nga impjantet e trajtimit të ujërave të ndotura

Ligj nr. 9115 datë 24.7.2003 “për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, amenduar me ligj nr. 34/2013

Miratuar VKM nr. 177 datë 31.03.2005 “për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”

Miratuar VKM nr. 127 datë 11.2.2015 “për kërkesat për përdorimin e llumrave në bujqësi”

Përgatitur draft VKM përkatëse (miratuar edhe me Vendim të KKU-së).

DIREKTIVA 98/83/EC PËR UJIN E PIJSHËM

- Përcaktimi i standarteve të ujit të pijshëm
- Hartimi i procedurave të monitorimit
- Hartimi i procedurave analitike
- Informim i publikut / publikime / këshillime në raste rreziku, etj.

Miratuar VKM nr. 379 datë 25.5.2016 për “Cilësinë e ujit të pijshëm”.

DIREKTIVA 2007/60/EC PËR PËRMBYTJET

- Hartimi i raporteve paraprake të vlerësimit të riskut nga përmbytja
- Përgatitja e hartave të ndryshme (për ndotësit e rrezikshëm, të zonave të riskut, etj)
- Hartimi i planeve të rrezikut nga përmbytja
- Vendosja e objektivave të qarta
- Përgatitje raportesh periodike dhe informimi i publikut

Përgatitur draft VKM përkatëse (është miratuar edhe me vendim të KKU-së).

DIREKTIVA 2006/7/EC PËR UJËRAT E LARJES

- Identifikimi i laboratorëve për kryerjen e analizave
- Përcaktimi i kriterëve për selektimin e ujërave të larjes
- Përcaktimi i ujërave si zona të larjes
- Përcaktimi i programit të monitorimit
- Përcaktimi i një sistemi klasifikimi për ujërat larës
- Vlerësimi i metodave dhe kushteve laboratorike
- Përgatitja e Udhëzuesve mbi metodat analitike

Miratuar VKM nr. 797 datë 29.9.2010 “Rregullorja higjeno – sanitare e ujërave të larjes”.

Miratuar VKM nr. 835 datë 30.11.2011 “Rregullorja higjeno-sanitare e pishinave”.

DIREKTIVA 2006/118/EC PËR UJËRAT NËNTOKËSORE

- Identifikimi i vlerave limite (*threshold values*), në nivel baseni / kombëtar
- Hartimi i një programi monitorimi
- Ndalimi i shkarkimit të substancave prioritare në ujërat nëntokësore, dhënia e autorizimeve aty ku është e nevojshme shkarkimi
- Mbajtja e një inventari të autorizimeve
- Hartimi i një programi masash zvogëluese për kufizimin /parandalimin e shkarkimit të ndotësve në ujërat nëntokësore
- Hartimi i masave për ndalimin e shkarkimeve nga burimet e shpërndara të ndotjes
- Publikim / informim i publikut

Përgatitur draft VKM përkatëse (është miratuar edhe me Vendim të KKU-së).

DIREKTIVA 91/676/EEC PËR NITRATET E PËRDORURA NË BUJQËSI

- Planifikimi / përgatitja e kodit të praktikave më të mira bujqësore për zonat vulnerabël ndaj nitrateve
- Hartimi i një programi për monitorimin e nitrateve me analizim të mostrave për të paktën 1 vit
- Përcaktimi i zonave vulnerabël ndaj nitrateve
- Hartimi i kriterëve për eutrofikimin dhe për ujëra të tjera të prekura
- Identifikimi i zonave/pikave ku do merren mostrat analizuese
- Përgatitja e broshurave, takimeve informuese me publikun, trajnimeve

Nuk është përgatitur ende asnjë praktikë ligjore për përafrimin e saj.

DIREKTIVA 2013/39/EU PËR SUBSTANCAT PRIORITARE

- Përcaktimi i standarteve të cilësisë së mjedisit dhe zbatimi rigoroz i tyre
- Përcaktimi i metodave të duhura të monitorimit konform kritereve të përcaktuara nga direktiva, shoqëruar me arsyetimin respektiv
- Identifikimi i frekuencave të monitorimit në sediment dhe/ose në biota (*monitorimi duhet të kryehet çdo 3 vjet*)
- Identifikimi i stacioneve të duhura të monitorimit (*në bazë të nr. popullsisë, sip. gjeografike, në raport me koeficientët e përcaktuar në direktivë*)
- Monitorimi i substancave të rrezikshme (prioritare) me qëllim të arritjes të statusit të mirë kimik të ujërave sipërfaqësore (*për të paktën 1 vit*)

Miratuar VKM nr. 267 datë 7.5.2014 “Lista e substancave prioritare në mjediset ujore”

Miratuar VKM nr. 246 datë 30.4.2014 “Normat e cilësisë së mjedisit për ujërat sipërfaqësore).

DIREKTIVA 2009/90/EC PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË MONITORIMIT

- Hartimi i një programi monitorimi konform kërkesave të direktivave
- Identifikimi dhe përdorimi i metodave të analizave për statusin kimik të trupave ujore, shoqëruar me arsyetimin përkatës (në përputhje me standartin EN ISO/IEC – 17025)
- Vlerësimi i kapaciteteve të laboratorëve – akreditimi i tyre
- Zhvillimi i programeve të testimit përpara analizimit të mostrave

Përgatitur draft VKM përkatëse (miratuar edhe me Vendim të KKU-së).

DIREKTIVA 2008/56/EC STRATEGJIA DETARE

- Hartimi i një strategjie për mbrojtjen e ujërave detare, statusin e tyre
- Përcaktimi i një programi monitorimi – metodologjia përkatëse
- Vlerësim fillestar i statusit të ujërave detare
- Analiza e presioneve dhe impakti i shkaktuar prej tyre
- Analizë ekonomiko-sociale e përdorimit të ujërave detare
- Përcaktimi i objektivave mjedisore
- Hartimi i programit të masave
- Informimi i publikut

Përgatitur draft VKM përkatëse.



Technical Secretariat of the
National Water Council

FALEMINDERIT !